



**csgd**

Qendra për Zhvillimin  
e Grupeve Shoqërore  
Center for Social  
Group Development

# Raport mbi testimin e situatës së diskriminimit ndaj lezbikeve, gejve dhe grave rome në fushën e qasjes në mallra dhe shërbime në Prizren



**Botues:**

Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore - CSGD

**Redaktor:**

Arbër Nuhiu

**Hulumtuese:**

Rita Selimi, Kandidate për PhD – Asistente në departamentin e Punës Sociale në UP

**Dizajn & Print**

NightDesign Studio

**Mohim përgjegjësie**

Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Heinrich-Böll-Stiftung, zyra në Beograd (HBS) dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Përmbajtja përgjegjësie e këtij publikimi është vetëm e CSGD-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e HBS dhe SIDA.

**E drejta e autorit**

© Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore - CSGD. Tetor 2023. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet ose të transmetohet në çfarëdo forme elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo ndryshe, pa lejen paraprake të CSGD.

Raport mbi testimin e situatës së  
**diskriminimit ndaj lezbikeve, gejve  
dhe grave rome në fushën e qasjes  
në mallra dhe shërbime në Prizren**



## Përmbajtja

1.	Hyrje.....	7
2.	Testimi i situatës .....	12
2.1.	Qyteti i Prizrenit .....	13
3.	Metodologjia .....	15
4.	Rezultatet .....	17
4.1.	Qasja në mallra dhe shërbime – identifikimi i situatave diskriminuese bazuar në orientim seksual.....	17
4.1.1.	Përvojat e Çifteve Lezbike .....	17
4.1.2.	Përvojat e çifteve gej .....	19
4.2.	Qasja në mallra dhe shërbime – identifikimi i situatave diskriminuese bazuar në përkatësinë etnike.....	20
5.	Diskutimi.....	22
5.1.	Rekomandime:.....	24
6.	Referencat .....	26



## 1. Përmbledhje ekzekutive

Në shoqëritë e sotme, lufta kundër diskriminimit është përpjekja kryesore në ndjekjen e drejtësisë sociale, barazisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Diskriminimi i bazuar në orientimin seksual dhe përkatësinë etnike mbetet ende fenomen shqetësues, që kërkon hulumtim, shqyrtim rigoroz dhe veprime gjithëpërfshirëse. Ky raport thellohet në një shqyrtim kritik duke përdorur metodologjinë e testimit të situatës së diskriminimit ndaj çifteve lezbike, gej dhe grave rome në qytetin e Prizrenit, Kosovë, me fokus të veçantë në qasjen e tyre në mallra dhe shërbime. Prizreni, si qyteti i dytë më i madh në Kosovë, njihet për diversitetin e tij të pasur kulturor dhe rëndësinë historike; ky qytet i zgjedhur si rast studimi shërben si një shembull i mikrokozmosit për të paraqitur situatën e komuniteteve të marginalizuara.

Gjetjet e hulumtimit tregojnë se çiftet lezbike dhe gej hasin shpesh forma delikate të diskriminimit kur qasen në mallra dhe shërbime në sektorin e kafiterive, na tregojnë që format më prezente të diskriminimit janë vështirësitë negative, pëshpëritjet, sjelljet pushtuese deri te shmangia fizike, kjo e fundit më së shumti evidente në hapësirat e orientuara me klientelë familjare (prind-fëmijë). Të gjeturat nënvizojnë se diskriminimi ose paragjykimi nuk kufizohet tek klientët, por shtrihet tek punonjësit. Përsa i përket grave rome, ndërsa studimi ynë nuk identifikoi vërejtje të qarta, shikime apo akte të drejtpërdrejta diskriminuese, të gjeturat tregojnë se në krahasim me gratë jo-rome, gratë rome shpesh kanë raportuar trajtim më pak miqësor nga stafi i kafenesë (mos përshëndetja, injorimi etj). Kjo formë më delikate e përjashtimit ose indiferencës kontribuon në ndjenjat e izolimit dhe marginalizimit tek gratë rome. Në të dyja rastet,

këto përvoja janë tregues të mikroagresioneve - forma delikate por tinëzare të diskriminimit që kërkojnë vëmendjen dhe veprim gjithëpërfshirës.

Hulumtimi synon të hedhë dritë mbi realitetet me të cilat përballen këto grupe të marginalizuara, duke matur shkallën e diskriminimit që hasin gjatë qasjes në mallra dhe shërbime. Përmes analizimit të të dhënave empirike, ky raport synon të kontribuoj me të dhëna dhe rekomandime të vlefshme për të luftuar diskriminimin, për të promovuar politika gjithëpërfshirëse dhe për të nxitur një shoqëri më të barabartë. Gjetjet e këtij raporti nënvizojnë rëndësinë e luftimit të diskriminimit në fronte të shumëfishta, nga rritja e ndërgjegjësimit deri te nxitja e mjediseve dhe politikave gjithëpërfshirëse.



## 2. Hyrje

Personat LGBTIQ+ (Lesbikë, Gej, Biseksualë, Transgjynerë, Interseks, Queer) dhe komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian përballen me diskriminim të vazhdueshëm dhe sfida në segmente të ndryshme shoqërore. Bindjet dhe pozicionimet individuale mbi këto grupe shpesh janë produkt i narracioneve kolektive që burojnë nga paragjykimet e rrënjësura thellë, pabarazitë dhe dijet e mirëmbajtura.

Historikisht, në shoqëritë që i përmbahen heteronormativitetit, ku ajo që konsiderohet e vërtetë dhe e pranueshme është e paracaktuar dhe ku mbizotëron besimi se të gjithë janë heteroseksualë, të qenurit person LGBTIQ+ bëhet gjithnjë e më sfiduese. Këto sfida përfshijnë aspekte të ndryshme, duke përfshirë ato sociale, psikologjike dhe ekonomike; pengesa të tilla i shtyjnë individët LGBTIQ+ në skajet e shoqërisë, duke e bërë të vështirë për ta pjesëmarrjen në hapësirat dhe mjediset shoqërore<sup>1</sup>. Paragjykimet me të cilat përballen personat LGBTIQ+ manifestohen përmes një sërë veprimesh sociale dhe kulturore që ndryshojnë në ashpërsinë e tyre, duke përfshirë forma të diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, përjashtimit social dhe madje edhe incidente të dhunës<sup>2</sup>.

Personat rom, ashkali dhe egjiptian në mënyrë të pashmangshme përballen me padrejtësi, pabarazi dhe përjashtim social. Diskriminimi sistematik është një faktor kryesor që i shtyn këto komunitete në skajet e shoqërisë në Kosovë, duke çuar në përjashtimin e tyre nga sferat e ndryshme shoqërore. Qasja në arsim është një padrejtësi prej problematikave kryesore, ku stereotipet brenda institucioneve arsimore

---

<sup>1</sup> Abrams, D., Hogg, M.A. & Marques, J.M. (2005). *The Social Psychology of Inclusion and Exclusion*. New York: Psychology Press.

<sup>2</sup> Suppes, A., Napier, J. L., & van der Toorn, J. (2019). The palliative effects of system justification on the health and happiness of lesbian, gay, bisexual, and transgender individuals. *Personality & social psychology bulletin*, 45(3), 372–388.

kanë penguar pjesëmarrjen e tyre në arsim, ku shkalla e braktisjes së shkollës mbetet e lartë. Përveç kësaj, në tregun e punës, shkalla e të papunësuarve të personave të këtyre komuniteteve mbetet mjaft e lartë. qeveria e Kosovës vlerëson një shkallë të papunësisë prej afro 95% në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Qasja e kufizuar në sektorin publik dhe diskriminimi në sektorin privat pengojnë mundësitë e tyre të integritit dhe marrjes së shërbimeve. Perceptimet negative sociale dhe format e shumta të diskriminimit ndaj këtyre komuniteteve ndodhin si në nivel institucional ashtu edhe në atë social. Në Kosovë, matjet rreth nivelit të homofobisë tregojnë se është një prej vendeve ballkanike me nivelet më të larta të homofobisë. Një pjesë e konsiderueshme e individëve LGBTIQ+ ndihen të detyruar të fshehin seksualitetin e tyre, të shmangin vende specifike për arsye sigurie dhe një pjesë e konsiderueshme kanë përjetuar abuzim verbal dhe fizik<sup>3</sup>.

Në anën tjetër, romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit në mënyrë të pashmangshme përballen me padrejtësi, pabarazi dhe përjashtim social. Diskriminimi sistematik është një faktor kryesor që i shtyn këto komunitete në skajet e shoqërisë në Kosovë, duke çuar në përjashtimin e tyre nga sferat e ndryshme shoqërore. Qasja në arsim është një padrejtësi prej problematikave kryesore, ku stereotipet brenda institucioneve arsimore kanë penguar pjesëmarrjen e tyre në arsim dhe shkalla e braktisjes së shkollës mbetet e lartë<sup>4,5</sup>. Përveç kësaj, në tregun e punës, shkalla e të papunësuarve të personave të

---

<sup>3</sup> World Bank Group (2018). Life on the Margins: Survey Results of the Experiences of LGBTI People in Southeastern Europe <http://documents1.worldbank.org/curated/en/123651538514203449/pdf/130420-REPLACEMENT-PUBLIC-FINAL-WEB-Life-on-the-Margins-Survey-Results-of-the-Experiences-of-LGBTI-People-in-Southeastern-Europe.pdf>

<sup>4</sup> Zyra për qeverisje të mirë (2017). Strategjia për përfshirjen e komunitetit romë, ashkali dhe egjiptias në shoqërinë Kosovare 2017-2021.

<sup>5</sup> TACSO (2015). Access to Education for Roma, Ashkali and Egyptian Communities in Kosovo. Prishtinë.

këtij komuniteti mbetet mjaft e lartë. Qasja e kufizuar në sektorin publik dhe diskriminimi në sektorin privat pengojnë mundësitë e tyre të integritit dhe marrjes së shërbimeve. Perceptimet negative sociale dhe format e shumta të diskriminimit ndaj këtyre komuniteteve ndodhin si në nivel institucional ashtu edhe në atë social.

Korniza të ndryshme teorike shpjegojnë pozicionimin shoqëror mbi “grupet e brendshme = ne” dhe “grupet e jashtme = ata/o” ku teoria e identitetit social fokusohet në mënyrën se si individët e kategorizojnë veten dhe të tjerët në grupe shoqërore dhe sesi ky proces mund të çojë në diskriminim dhe paragjykim ndërgrupor. Në të dyja rastet, kjo teori na ndihmon të kuptojmë se si procesi i kategorizimit dhe nevoja për identitet social mund të kontribuojnë në stigmën dhe refuzimin që përjetojnë grupet e marginalizuara. Ndërsa, teoria e stresit të pakicave është një tjetër kornizë teorike që eksploron stresorët dhe sfidat unike me të cilat përballen individët nga komunitetet e marginalizuara. Kjo teori supozon se individët që i përkasin grupeve minoritare të stigmatizuara përjetojnë një nivel të lartë stresi për shkak të paragjyqimeve, diskriminimit dhe refuzimit social. Për romët, ashkalitë dhe egjiptiasit, kjo mund të shfaqet si diskriminim në strehim, arsim dhe punësim, duke rezultuar në rritjen e niveleve të stresit që mund të ndikojë negativisht në shëndetin e tyre mendor dhe fizik. Ndërsa, për personat LGBTIQ+, të tillë janë faktorët stresues që lidhen me paragjykimet shoqërore dhe diskriminimin bazuar në orientimin seksual ose identitetin gjinor, ku kjo përfshin përvoja të tilla si homofobia, transfobia dhe përjashtimi social. Rrjedhimisht, të dy grupet mund të jenë më të predispozuar ndaj çështjeve të

vështirësive të shëndetit mendor, abuzimit me substancat dhe aspekteve tjera të dëmshme shëndetësore si rezultat i këtyre stresorëve të vazhdueshëm<sup>6</sup>.

Studimi mbi Testimin e Situatës së Diskriminimit ndaj Lezbikeve, Gejve, dhe Grave Rome në Fushën e Qasjes në Mallra dhe Shërbime dhe Qasjes në Strehim ishte kryer për herë të parë në Prishtinë, Kosovë në 2021, ku të gjeturat tregojnë se në dy segmentet qoftë në qasje në shërbime po ashtu dhe në strehim, kishte forma të diskriminimit. Në situatat e qasjes në kafiteri, çifti gej ishin më të diskriminuarit, ku aktet e diskriminimit ishin injoranca, shikimi, tallja, bërja shaka, madje edhe kërcënimet për dhunë fizike. Ndërsa për gratë Rome, kjo ishte më e shprehur në vonesa në shërbime<sup>7</sup>. Sa i përket qasjes në strehim, çiftet e seksit të njejtë nuk u refuzuan plotësisht por kishte raste kur pas kuptimit të orientimit seksual, agjentët u përgjigjen me arsyeime se pse apartamenti nuk ishte më i disponueshëm për qira; ndërsa për gratë rome kishte raste ku ofroheshin apartamente por me kushte të papërbalueshme dhe jo konform kërkesës së palës. Të gjeturat e këtij raporti sinjalizuan mbi rëndësinë e hulumtimit të kësaj teme dhe në qytetet tjera të Kosovës si dhe ofroi evidenca empirike për avokim të politikave dhe përmisimin e praktikave.

Rrethanat dhe gjetjet e tilla që dëshmojnë mbi gjasat e diskriminimit dhe refuzimit të përjetuar nga të dy komunitetet shërben si një thirrje urgjente për t'u thelluar në këtë temë në mënyrë që të identifikohen hapësirat specifike ku këto komunitete vazhdojnë të përballen me barriera të rëndësishme për qasjen në shërbimet thelbësore dhe pjesëmarrjen në jetën e përditshme. Pavarësisht nëse bëhet

---

<sup>6</sup> Meyer I. H. (2003). Prejudice, social stress, and mental health in lesbian, gay, and bisexual populations: conceptual issues and research evidence. *Psychological bulletin*, 129(5), 674–697.

<sup>7</sup> QKSGJ & CSGD (2021). Raport mbi Testimin e Situatës së Diskriminimit ndaj Lezbikeve, Gejve, dhe Grave Rome në Fushën e Qasjes në Mallra dhe Shërbime dhe Qasjes në Strehim në Kosovë, marrur nga: <https://csqd-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/ST-Report-ENG.pdf>

fjalë për qasjen e kufizuar në hapësirë publike, kujdesin shëndetësor, arsimin, strehimin, është e qartë se paragjykimet sistemike vazhdojnë. Duke i shqyrtuar në mënyrë kritike këto hapësira dhe duke adresuar paragjykimet e rrënjosura brenda tyre, mund të përpiqemi të krijojmë një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.

### 3. Testimi i situatës

Testimi i situatës është një metodë eksperimentale që përdoret për të identifikuar raste të diskriminimit. Për të arritur këtë objektiv, krijohen grupe eksperimentale, të përbërë nga individë që zotërojnë disa karakteristika personale që historikisht kanë çuar në diskriminim. Në anën tjetër, formohen grupe kontrolli, të përbëra nga individë që nuk ndajnë të njëjtën karakteristikë specifike, por përndryshe janë të ngjashëm në të gjitha aspektet përkatëse. Çdo trajtim ndryshe i përjetuar nga grupi eksperimental, i cili nuk mund t'i atribuohet ndonjë faktori tjetër përveç diskriminimit shqyrtohet më pas.

Në testimin e situatës, ndahen dy grupe, testuesit dhe kontroll testuesit, ku dy individëve u caktohen identitete dhe kualifikime fiktive që përputhen ngushtë në të gjitha aspektet por dallimi i vetëm midis këtyre individëve qëndron në karakteristikën që po hulumtohet (pra, orientimi seksual apo përkatësia etnike). Aspekti i saktë metodologjik të testimit të situatës qëndron në atë që testuesit duhet të kenë ngjashmëri në çdo aspekt dhe i vetmi dallim duhet të jetë karakteristika që po testohet, pastaj të njëjtit dërgohen në vendin/lokalitetin ku hulumtohet në rast se ndodh diskriminimi (në këtë rast, kafenetë) dhe në rast se testuesit marrin trajtim ndryshe nga kontroll testuesit atëherë identifikohet se diskriminimi është shkaku kryesor, pasi ndryshimi i vetëm midis tyre është karakteristikë specifike. Testimi i diskriminimit mund të kryhet përmes dy qasjeve; a) duke u bazuar në rastet e raportuara të diskriminimit ku tanimë ka evidence të raportuara se në x rastin ka ndodhur diskriminimi dhe b) mënyrë proaktive që nënkupton testohet situata përmes

hulumtimit dhe nuk ka informata paraprake se vendi/lokaliteti i caktuar ka historik të diskriminimit<sup>8</sup>.

Si metodologji, testimi i situates ndodh për disa qëllime si:

- Përcaktimi i diskriminimit dhe faktet që lidhen me disa praktika diskriminuese
- Sigurimi i dëshmive
- Raste Gjyqësore – procesi gjyqësor strategjik
- Avokimi dhe ngritja e vetëdijes
- Hulumtimi

### 3.1. Qyteti i Prizrenit

Prizreni, i vendosur në pjesën jugore të Kosovës, është një qytet me një histori të pasur socio-kulturore. Historia e qytetit shënohet nga trashëgimia e tij multikulturore, me ndikime nga qytetërime të ndryshme; Qyteti njihet për trashëgiminë e tij të larmishme fetare dhe bashkëjetesën e komuniteteve religjioze në harmoni. Për më tepër, Prizreni është i njohur për skenën kulturore, ku me shënimin e festivalit vjetor Dokufesti, qyteti është bërë një qendër kulturore që tërheq vizitorë mbarëkombëtar. Jeta socio-kulturore e Prizrenit karakterizohet me faktin që kulturat dhe traditat e ndryshme ndërveprojnë, duke ofruar një përvojë unike dhe të gjallë socio-kulturore<sup>9</sup>.

Përfshirja e Prizrenit si rast studimi në raportin tonë për të eksploruar situatën e diskriminimit me të cilin përballen personat LGBTIQ+ dhe gratë rome është thelbësore. Së pari, Prizreni ofron një kontekst unik socio-kulturor të ndryshëm nga Prishtina, kryeqyteti i Kosovës ku dinamika historike, demografike dhe sociale e Prizrenit dallon dukshëm, duke e bërë thelbësore të shqyrtohet se si manifestohet diskriminimi në rajone të ndryshme të Kosovës. Së dyti, trashëgimia multikulturore e

---

<sup>8</sup> Chalovska, N. (2014). Situation testing: A method of proving discrimination. OSCE, Skopje. ISBN 978-608-65216-7-7

<sup>9</sup> Halili, B. (2013). The Culture and Tourism in the City of Prizren (Socio-Cultural Psychological and Antopological Reflection). Mediterranean Journal of Social Sciences 4(4) DOI:10.5901/mjss.2013.v4n4p205

Prizrenit dhe popullsia e larmishme ofron mundësinë të identifikohej specifikat me të cilat përballen si individët LGBTIQ+ ashtu edhe gratë rome brenda një konteksti diversiteti kulturor.

Pra, përfshirja e Prizrenit si rast studimor krahas Prishtinës është instrumental në ofrimin e një nuance tjetër të kuptuarit të dinamikës së diskriminimit, njohjen e variacioneve rajonale dhe sigurimin që rekomandimet gjegjëse të jenë të bazuara në evidencat empirike të evidentuara në disa kontekste/lokalitete.



#### 4. Metodologjia

Procedura e hulumtimit kaloi disa faza, fillimisht u bë një analizë mbi përcaktimin e qytetit në të cilin do realizohej hulumtimi dhe fusha kryesore – këtë rast, qasja në mallra dhe shërbime konkretisht qasjen në kafiteri ku u përzgjedh Prizreni si qyteti i dytë më i madh në Kosovë që karakterizohet dhe me një diversitet socio-kulturor. Për kafiteritë e përzgjedhura u përdor mostra e rastësishme, rregulla e dorës së djathtë ku nga një pike e përcaktuar orientuese u përzgjedh çdo e treta (3) kafiteri me rend dhe vizita e çifteve ishte me 3 ditë pauzë kohore ndërmjet (shembull: e henë, çifti gej dhe e enjte çifti lezbike).

Pas kësaj, u mbajt trajnimi me koordinatoren e hulumtimit (koordinatorja kishte tashmë përvojë nga hulumtimi i kaluar) lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë specifike gjatë procesit të hulumtimit. Pas kësaj, u përzgjedhën testuesit dhe kontroll testuesit, ku nga ta ishin dy (2) individë që kishin rolin e çiftit gej, dy (2) të çiftit lezbike, dy (2) gra rome në rolin e shoqeve dhe dy (2) gra jo rome në po të njëjtin rol. Gjatë përzgjedhjes së testuesve, ishin të rëndësishme detajet si: aftësia për të bërë vëzhgime objektive, mungesa e paragjytimeve, besueshmërinë, sigurinë, aftësia për të shtypur ndjenjat e tyre gjatë testimit, qetësia, mos-pirja ndaj provokimeve, vetëdija e mirë, aftësia për të menduar/reflektuar.

Pas gjetjes së testuesve dhe kontroll testuesve, u mbajt trajnimi përgaditor në të cilën u shpjegua në detaje qëllimi, procedura, metodologjia, skenarët potenciale dhe performimi i koreografisë së sjelljes e cila duhet të ishte e njëjtë në mënyrën se si shfaqej afeksioni në mes çifteve dhe detajet tjera të sjelljes në rastin e grave rome dhe jo-rome.

Testimi i situatës së diskriminimit bazuar në orientimin seksual në qasjen në mallra dhe shërbime u krye duke formuar tre çifte testuese të cilët kishin për detyrë të testonin reagimin e stafit dhe mysafirëve të tjerë ndaj veprimit të tyre si çift (që do të thotë, duke shprehur orientimin seksual): çift lezbik, çift gej dhe çift heteroseksual kontrollues. Çiftet e vizitonin kafiterinë në të njejtën kohë, ku çifti heteroseksual hynte 5 minuta më vonë për të testuar dhe kohën e pritjes për marrjen e shërbimit dhe uleshin në pozicion ku kishin qasje tek të gjithë (ose pothuajse të gjithë) mysafirët/stafi në mënyrë që të vëzhgonin të gjithë. Sjellja e çifteve duhet të ishte me afeksion ndaj njëri-tjetrit, pra prekje të lehta, përqafime, shiqime etj por jo puthje.

Testimi i situatës së diskriminimit ndaj grave Rome në fushën e qasjes në mallra dhe shërbime u krijua në formën e formimit të dy palëve testuese - dy gra Rome që veprojnë si shoqe që vizitojnë kafiteritë në Prizren dhe dy gra shoqe jo-Rome. Ato kishin për detyrë të vëzhgonin kohën e pritjes për shërbimin, sjellja e stafit në bare dhe sjellja e mysafirëve të tjerë ndaj tyre.

Pas vizitave në kafiteri, testuesit dhe kontroll testuesit u udhëzuan të reflektojnë dhe plotësojnë raportin ndaras nga njëri-tjetri. Raporti fokusohej në pyetjet reflektuese si: Struktura e mysafiri (Struktura e mysafirve (karakteristikat si mosha, raportet, lloji i klientelës), pritja për shërbimin, qasja e kamarierit/es, përshtkrimi në detaje i interaksionit të tyre ngjatë qëndrimit në kafiteri, qasja e mysafirve tjerë, komentimi nga stafi/klientela dhe komentet shtesë.

## **5. Rezultatet**

### **5.1. Qasja në mallra dhe shërbime – identifikimi i situatave diskriminuese bazuar në orientim seksual**

Gjetjet e këtij studimi nxjerrin në pah sfidat me të cilat përballen çiftet lezbike dhe gej, kur qasen në mallra dhe shërbime në kafeteri. Këto përvoja shpesh përfshijnë forma delikate të diskriminimit, të tilla si vështtrimet e rastësishme, sjelljet pushtuese dhe me raste incidente rrethore që implikojnë kërcënime fizike. Për më tepër, ky hulumtim thekson nevojën urgjente për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit lidhur me çështjet LGBTIQ+ brenda shoqërisë në mënyrë që jetesa e përditshme e këtyre personave të jetë e dinjitetshme; Ku në rastin konkret thekson nevojën e ngritjes së vetëdijes ku rrjedhimisht individët dhe stafi në hapësirat publike t'i trajtojnë të gjithë klientët me respekt dhe dinjitet, pavarësisht nga orientimi i tyre seksual.

#### **5.1.1. Përvojat e Çifteve Lezbike**

Në studim, përvoja e çifteve lezbike karakterizohej me shiqime përrulëse, nënqimim, interes të shtuar për interaksionin e tyre, komente dhe në disa raste incidente direkte. Të gjeturat nga studimi paraprak i kryer në qytetin e Prishtinës<sup>10</sup> tregonin aktet diskriminuese për çiftin lezbike të mos ishin aq dramatike sa në rastin e çiftitij gej dhe ato përfshinin shikimin, injorancën dhe fyerjen, ku shpesh komentet ishin seksiste ndërsa këtë herë aktet diskriminuese ishin më të ashpëra dhe kërcënuese.

---

<sup>10</sup> QKSGJ & CSGD (2021). Raport mbi Testimin e Situatës së Diskriminimit ndaj Lezbikeve, Gejve, dhe Grave Rome në Fushën e Qasjes në Mallra dhe Shërbime dhe Qasjes në Strehim në Kosovë, marrur nga: <https://csqd-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/ST-Report-ENG.pdf>

Çifti gjatë përvojës së tyre hasën në disa incidente të ndryshme gjatë vizitave të tyre në kafene, në një rast kur testimi ndodhi në një kafene e cila frekuentohet kryesisht nga struktura e familjeve, pas mbërritjes së çiftit lezbike, gjithë familjet që ishin afër u larguan menjëherë nga kafeneja, ku në një moment të caktuar ishte dhe një nënë që madje i largoi fëmijët e saj për të mos i pasur përballë çiftin lezbike. Ky largim i papritur i familjeve lë të kuptohet për shqetësimet dhe parahatinë që disa klientë ndjenin në praninë e çiftit lezbike, duke treguar një shqetësim të mundshëm që shoqëria ka kur mund të ketë shfaqje/shprehje publike të dashurisë ndaj çifteve të të njëjtit seks në hapësirat publike. Një tjetër incident përfshinte ndjekjen e njëres vajzë lezbike deri në tualet nga një grup i djemve. Megjithëse nuk ka pasur asnjë komunikim verbal, akti i të qenit në ndjekje nga persona të huaj mund të interpretohet si armiqësor. Një sjellje e tillë ngre shqetësime për hapësirën personale dhe cenimin e privatësisë. Në një rast tjetër, pasi çifti lezbike doli nga kafeteria, një burrë u vu re duke pritur çiftin jashtë ndërsa ishte në një bisedë telefonike. Kjo situatë mund të shihet si një formë mbikëqyrjeje ose frikësimi, duke krijuar një ndjenjë cënueshmërie dhe shënjestrimi.

Ndërsa, përveç incidenteve që kishin karakter më direkt, shikimet nga klientët e tjerë, përqeshjen apo komentet, si në një rast ku nga kontroll testuesit u raportua një koment nga klientela "Ohh u prekën valla", çifti lezbikeve në raportimin e tyre këto ia atribuon faktorëve të tillë si veshja e tyre ose mënyra se si mund të jenë perceptuar. Kjo tendencë e justifikimit/racionalizimit të sjelljes jo-direkt diskriminuese/kërcënuese sugjeron një prirje për të racionalizuar ose minimizuar diskriminimin e mundshëm, ndoshta si një mjet për vetë-mbrojtje.

### 5.1.2. Përvojat e çifteve gej

Çiftet gej raportuan përvoja të dallueshme kur vizitonin kafenetë. Ata hasnin shpesh vështirime të rastësishme nga klientët meshkuj, të shoqëruar shpesh me shprehje habie, nënçmimi dhe komentet; të gjitha këto bëheshin më evidente gjatë ardhjes dhe daljes nga kafiteria. Këto shikime dukej se pasqyronin kuriozitetin ose gjykimin në lidhje me orientimin seksual të çifteve, duke treguar një tendencë shoqërore për të shqyrtuar dhe gjykuar individët LGBTIQ+ bazuar në pamjen dhe sjelljen e tyre. Ndërsa, për dallim nga çifti lezbike, këta nuk kishin hasur në incidente direkte që implikonin situatë kërcënuese fizikisht përveç një komenti ku pas daljes nga kafiteria, kontroll testuesit raportuan që klientela në kafiteri komentoj "Phuu q\*\*fsha pederat" .

Si çiftet lezbike dhe gej raportuan raste kur stafi i kafenesë shfaqti sjellje të pazakontë ose nënçmuese ndaj tyre. Kjo nënvizon se diskriminimi ose paragjykimi nuk kufizohet vetëm te klientët, por shtrihet te punonjësit brenda këtyre institucioneve, duke përforcuar më tej një atmosferë armiqësore, e gjetura e njejtë ishte dhe në studimin paraprak të kryer nga QKSGJ & CSGD (2021)<sup>11</sup>. Përveç kësaj, në dy raste të veçanta, stafi i kafenesë iu qas çifteve lezbike dhe gej në gjuhë angleze, duke sugjeruar që sjellja ose seksualiteti i tyre mund të shpjegohej vetëm duke qenë të huaj. Ky supozim nënvizon ndikimin e stereotipeve dhe paragjykimeve në ofrimin e shërbimeve.

---

<sup>11</sup> QKSGJ & CSGD (2021). Raport mbi Testimin e Situatës së Diskriminimit ndaj Lezbikeve, Gejve, dhe Grave Rome në Fushën e Qasjes në Mallra dhe Shërbime dhe Qasjes në Strehim në Kosovë, marrur nga: <https://csgd-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/ST-Report-ENG.pdf>

Raportimet nga grupi i kontroll testuesve pasqyronin se në shumicën e rasteve vështruan se njerëzit reagonin me neveri të dukshme, shfaqnin shprehje të pakëndshme të fytyrës dhe bënë komente të heshtura ndaj çiftit gej dhe lezbike.

## **5.2. Qasja në mallra dhe shërbime – identifikimi i situatave diskriminuese bazuar në përkatësinë etnike**

Të gjeturat e këtij studimi tregojnë se në rastin e grave rome, nuk kishte komente apo vështrimeve diskriminuese gjithsesi kishte forma të tjera që aludojnë për një kulturë “të heshtur” të përjashtimit. Të gjeturat e studimit paraparak theksonin njëjtë këtë kulturë por aktet e diskriminimit ishin në vonesë në shërbim<sup>12</sup>.

Këto rezultate tregojnë që të paktën në kontekstin e kafeterive të studiuara, nuk kishte shenja të hapura të diskriminimit etnik ose paragjyqimeve ndaj grave rome. Ky konstatim është në kontrast me stereotipet dhe paragjykimet mbizotëruese me të cilat përballen shpesh individët romë. Ndryshe nga mungesa e vërejtjeve apo vështrimeve diskriminuese, kontroll testueset jo-rome raportuan se stafi në kafeteri ishte përgjithësisht më miqësor ndaj tyre në krahasim me grate rome. E njëjta u raportua nga gratë romet cilat raportuan shumë shpesh se pas shprehjes së falenderimeve për shërbimin ose përshëndetjes, stafi i kafenesë nuk u kthente përgjigje dhe nuk i përshëndeste. Kjo sjellje mund të nënkuptojë një formë delikate të përjashtimit ose indiferencës ndaj grave rome, e cila mund të kontribuojë në ndjenjat e izolimit, marginalizimit dhe mos frekuentimin e hapësirave.

Rezultatet e këtij studimi paraqesin një tablo komplekse të përvojave të grave rome kur aksesojnë mallra dhe shërbime në kafeteri. Ndërsa mungesa e vërejtjeve apo

---

<sup>12</sup> ibid

vështrimeve diskriminuese është një gjetje pozitive, është e rëndësishme të pranohet se diskriminimi mund të marrë forma më delikate. E gjetura se kontroll testuesit jorom morën trajtim më miqësor nga stafi ngre shqetësime për ofrimin e barabartë të shërbimeve. Kjo pabarazi në trajtim mund të jetë tregues i paragjytimeve të pavetëdijshme ose stereotipeve të mirëmbajtura nga stafi i kafenesë. Është thelbësore të adresohen këto paragjytime dhe të sigurohet që të gjithë klientët të trajtohen me respekt dhe mirësjellje, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike.

## 6. Diskutimi

Gjetjet e këtij studimi reflektojnë mbi përvojat e çifteve LGBTIQ+ dhe grave rome kur qasen në mallra dhe shërbime në kafeteri. Përvojat e raportuara nga çiftet lezbike dhe gej në kafeteri karakterizohen nga një ndërveprim kompleks i dinamikave sociale. Të gjeturat na tregojnë që format më prezente të diskriminimit janë vështrimet negative, pëshpëritjet deri te shmangia fizike, kjo e fundit më së shumti evidente në hapësirat e orientuara me klientelë familjare (prind-fëmijë). Reagimet e stafit, që herë pas here shfaqte sjellje të pazakontë ose nënçmuese ndaj çifteve LGBTIQ+, sugjeron se diskriminimi ose paragjykimi nuk kufizohet vetëm tek klientët, por shtrihet edhe tek punonjësit brenda. Për më tepër, rastet kur stafi aludoi se çiftet ishin të huaj për shkak të sjelljes ose seksualitetit të tyre, theksojnë ndikimin e stereotipeve dhe paragjytimeve në ofrimin e shërbimit. Përvojat e grave rome në kafeteri tregojnë se edhe pse nuk kishte vërejtje, vështrime apo akte direkte diskriminuese drejtuar grave rome, trajtim më miqësor nga stafi i kafeneve ishte ndaj grave jo-rome. Këto nënkuptojnë një formë delikate të përjashtimit ose indiferencës ndaj grave rome, e cila, megjithëse nuk është haptazi diskriminuese, mund të kontribuojë në ndjenjat e izolimit dhe marginalizimit.

Aktet diskriminuese ndaj gjithë grupeve të testuara aludonin mbi një formë “të heshtur” të përjashtimit, ku shpesh herë kjo formë e diskriminimit përbën një sfidë të veçantë për viktimat, sepse është e vështirë të identifikohet dhe të ndërmerret veprime kundër saj. Kjo mund të çojë në një ndjesi të përhershme të paqëndrueshmërisë dhe mosbesimit në mjediset publike.

Të gjeturat tregojnë se gratë lezbike u përballën me forma më të ashpërta të diskriminimit, kjo mund të shpjegohet në disa mënyra, a) shpesh herë gratë lezbike



mund të përballen me diskriminim jo vetëm bazuar në orientimin e tyre seksual, por edhe për shkak të bindjeve dhe stereotipeve që ekzistojnë për gratë. Kjo ndërlidhje mund të rezultojë në sfida dhe forma unike të diskriminimit ku inkorporohet homofobia dhe mizogjia; b) Shoqëria ndonjëherë seksualizon dhe fetishizon marrëdhëniet lezbike, duke i perceptuar ato si më shumë për kënaqësinë e të tjerëve (d.m.th., për shikimin mashkullor - male gaze) ku kjo mund të çojë në forma të ndryshme dhe potencialisht më intensive të diskriminimit, pasi objektivizon dhe zhvlerëson marrëdhëniet lezbike; c) Në disa rajone apo kontekste socio-kulturore, diskriminimi ndaj grave lezbike mund të jetë më i theksuar për shkak të paragjytimeve dhe traditave të rrënjosura thellë.

Reagimet nga stafi i kafeterisë, duke shfaqur herë pas here sjellje të pazakonta ose nënçmuese ndaj çifteve LGBTIQ+ dhe grave jo-rome, pasqyrojnë konceptin e mikroagresioneve. Mikroagresionet janë akte ose komente delikate, shpesh të paqëllimshme që komunikojnë armiqësi ose paragjykim ndaj individëve nga grupet e marginalizuara. Këto mikroagresione nxjerrin në pah përhapjen e paragjytimeve dhe stereotipeve, ato kontribuojnë në një mjedis armiqësor dhe mund të kenë ndikime të rëndësishme psikologjike dhe emocionale te grupet që përjetojnë ato. Të njëjtat kanë peshë të konsiderueshme pasi mund të kontribuojnë në një mjedis armiqësor, të ndikojnë vetëvlerësimin dhe të nxisin një ndjenjë tjetërsimi ku me kalimin e kohës, ndikimi kumulativ i mikroagresioneve mund të çojë në stres të shtuar, ankth dhe ulje të mirëqenies emocionale.

## **7. Rekomandime:**

Përveç të dhënave të vlefshme të mbledhura mbi diskriminimin ndaj çifteve LGBTIQ+ dhe grave rome, këshillohet fuqimisht që organizatat e avokimit t'i shfrytëzojnë këto gjetje për të formuluar strategji më gjithëpërfshirëse të avokimit. Këto strategji duhet të dizajnohen për të përmirësuar pozitën sociale dhe të drejtat e këtyre grupeve të marginalizuara brenda shoqërisë kosovare.

**7.1 Ndërgjegjësimi dhe dukshmëria:** Një objektivi kryesor i këtyre strategjive të avokimit duhet të jetë rritja e ndërgjegjësimit për diskriminimin dhe funksionalizimi i mekanizmave themelorë. Duke vepruar kështu, bëhet e mundur që çështja të shndërrohet nga një problem i bazuar në prova anekdotike në një problem të mirë-dokumentuar dhe të bazuar në prova.

**7.2 Avokimi i bazuar në dëshmi (hulumtime):** Duke shfrytëzuar rezultatet e testimi të situatës, organizatat mund t'i bazojnë fushatat dhe iniciativat e tyre në prova konkrete. Kjo qasje e bazuar në prova i jep besueshmëri dhe peshë përpjekjeve të tyre, duke e bërë më të mundshme që politikëbërësit dhe publiku ta marrin seriozisht diskriminimin ndaj grupeve të marginalizuara.

**7.3 Edukimi dhe sensibilizimi:** Promovimi i programeve arsimore dhe fushatave sensibilizuese që synojnë segmente të ndryshme të shoqërisë, duke përfshirë zyrtarët e qeverisë, agjencitë e zbatimit të ligjit, institucionet arsimore dhe publikun e gjerë. Këto programe duhet të synojnë të largojnë stereotipet, të promovojnë tolerancën dhe të krijojnë një mjedis ku festohet diversiteti.

**7.4 Krijimi i politikave kundër diskriminimit dhe ofrimi i trajnimeve:** Ofrimi i trajnimeve gjithëpërfshirëse për të gjithë punonjësit mbi diversitetin, përfshirjen dhe

ndjeshmërinë kulturore. Trajnimi që përfshijnë skenarë që lidhen me shërbimin dhe ndërveprimin me individët LGBTQ+ dhe gratë rome.

**7.5 Aktivizimi i mekanizmave të raportimit:** Në bashkëpunim me komunat, avokoni që aktet diskriminuese të raportohen në Departamentin e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të krijohen formularë konfidencial ku klientët mund të ndajnë në mënyrë anonime përvojat e tyre dhe sugjerimet për përmirësim.

**7.6 Rekomandime për ndryshimin e politikave:** Zhvilloni dhe propozoni rekomandime specifike të politikave bazuar në gjetjet e testimit të situatës. Këto rekomandime duhet të fokusohen në mbylljen e boshllëqeve ligjore, rritjen e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe sigurimin e trajtimit të barabartë për grupet e marginalizuara.

**7.7 Trajnimi i përfaqësuesve të gastronomisë:** Paraqitja e të gjeturave dhe informimi i tyre me terminologjinë, çështjet LGBTI+ dhe Roma si dhe me politikat/ligjet në fuqi që dënojnë diskriminimin në të gjitha format.

Si përfundim, testimi i situatës është një mjet i fuqishëm jo vetëm për të hedhur dritë mbi diskriminimin, por edhe për të nxitur përmirësime të prekshme në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ndërgjegjësimin për sfidat me të cilat përballen grupet e marginalizuara. Duke zhvilluar strategji avokuese të bazuara në dëshmi që synojnë aspektet institucionale dhe publike të diskriminimit, mund të punohet drejt një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe më të barabartë në Kosovë.

## 8.Referencat

Abrams, D., Hogg, M.A. & Marques, J.M. (2005). The Social Psychology of Inclusion and Exclusion. New York: Psychology Press.

Suppes, A., Napier, J. L., & van der Toorn, J. (2019). The palliative effects of system justification on the health and happiness of lesbian, gay, bisexual, and transgender individuals. *Personality & social psychology bulletin*, 45(3), 372–388-388.

World Bank Group (2018). Life on the Margins: Survey Results of the Experiences of LGBTI People in Southeastern Europe  
<http://documents1.worldbank.org/curated/en/123651538514203449/pdf/130420-REPLACEMENT-PUBLIC-FINAL-WEB-Life-on-the-Margins-Survey-Results-of-the-Experiences-of-LGBTI-People-in-Southeastern-Europe.pdf>

Zyra për qeverisje të mirë (2017). Strategjia për përfshirjen e komunitetit romë, ashkali dhe egjiptias në shoqërinë Kosovare 2017-2021.

TACSO (2015). Access to Education for Roma, Ashkali and Egyptian Communities in Kosovo. Prishtinë.

Halili, B. (2013). The Culture and Tourism in the City of Prizren (Socio-Cultural Psychological and Antopological Reflection). *Mediterranean Journal of Social Sciences* 4(4) DOI:10.5901/mjss.2013.v4n4p205

Meyer I. H. (2003). Prejudice, social stress, and mental health in lesbian, gay, and bisexual populations: conceptual issues and research evidence. *Psychological bulletin*, 129(5), 674–697.

QKSGJ & CSGD (2021). Raport mbi Testimin e Situatës së Diskriminimit ndaj Lezbikeve, Gejve, dhe Grave Rome në Fushën e Qasjes në Mallra dhe Shërbime dhe

Qasjes në Strehim në Kosovë, marrur nga: <https://csgd-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/ST-Report-ENG.pdf>

Chalovska, N. (2014). Situation testing: A method of proving discrimination. OSCE, Skopje. ISBN 978-608-65216-7-7

